



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

KKPM-2010/02

RREGULLORE PËR NIVELIN DHE MËNYRËN E PAGESËS SË TAKSËS SË LICENCËS PËR SHËRBIMET MEDIALE AUDIO-VIZUALE

PREAMBULA

Bazuar në Nenin 16.1 dhe Nenin 16.2 të Ligjit Nr.02/L-15 për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media miraton këtë Rregullore.

Neni 1

Qëllimi i Rregullores

Kjo rregullore do të përcaktoj:

- 1.1 Nivelin e taksës së vetme për regjistrim në lidhje me aplikacionet për licencë të transmetimit për shërbime mediale audio-vizuale.
- 1.2 Nivelin e taksës së vetme për aktivitetet në lidhje me regjistrimin e aplikuesit për lëshim, ndryshim apo vazhdim të licencës të transmetimit të shërbimeve mediale audio-vizuale.
- 1.3 Nivelin, mënyrën e përcaktimit të pagesës së taksës vjetore për licencë të shërbimeve mediale audio-vizuale.

Neni 2

Niveli i taksës së vetme për regjistrimin të aplikacioneve

- 2.1 Taksa e vetme do të ngarkohet për regjistrim të aplikacioneve, të përcaktuar me anë të kësaj rregullore.
- 2.2 Aplikuesit për licencë të shërbimeve mediale audio-vizuale duhet ta paguajnë një taksë administrative paushalle, në shumën prej njëqind (100) euro në llogarinë bankare të KPM-së, me rastin e dorëzimit të aplikacionit.

Neni 3
Kriteret e vlerësimit të Taksës Vjetore

- 3.1 Kriteret e vlerësimit të taksës vjetore për subjektet transmetuese tokësore përcaktohen në bazë të:
- a. Vlerës bazë të shprehur **(A)** – e llogaritur në bazë të buxhetit të përgjithshëm vjetor e pjesëtuar me numrin e subjekteve të licencuara transmetuese tokësore, numrin e ditëve të vitit dhe me 24 orë;
 - b. Mesataren e numrit të banorëve të mbuluar **(B)**;
 - c. Llojit të subjektit transmetues tokësor **(C)** – radio dhe TV dhe
 - d. Kategorisë së subjektit transmetues tokësor **(D)**.
- 3.2 Kriteret e vlerësimit të taksës vjetore për operatorët kabllor përcaktohen në bazë të:
- a. Numrit të banorëve **(A)**;
 - b. Numri i parapaguesve potencial **(B)**;
 - c. Përpjesëtimi i tregut **(C)**;
 - d. Çmimi mesatar i parapagimit **(D)** dhe
 - e. Përqindja e buxhetit të përgjithshëm **(E)**.
- 3.3 Për ofruesit e shërbimeve programore vlera e taksës vjetore është përcaktuar e njëjtë me subjektet transmetuese tokësore me mbulim regional.

Neni 4
Tarifat vjetore të Taksës për licencë

4.1 SUBJEKTET TRANSMETUESE TOKËSORE

Niveli i taksës vjetore të licencës për subjektet transmetuese tokësore është përcaktuar në tabelën si në vijim:

Lloji i subjekteve transmetues tokësore	A	B	C	D	Shuma vjetore (€)
Radio me fuqi të ulët	20	1	1	1	240.00
TV me fuqi të ulët	20	1	1.5	1	360.00
Radio lokale	20	1.5	1	1.5	540.00
TV lokale	20	1.5	1.5	1.5	810.00
Radio regjionale	20	3	1	1.75	1,260.00
TV regjionale	20	3	1.5	1.75	1,890.00
Radio nacionale	20	21	1	2	10,080.00
TV nacionale	20	21	1.5	2	15,120.00

4.2 OPERATORËT KABLLOR

4.2.1. Shuma e taksës vjetore për licence për operatorët kabllorë do të llogaritet për secilën komunë dhe zonë kadastrale në të cilën operatori kabllorë e ka të shtrirë rrjetin e tij kabllorë.

Niveli i taksës vjetore të licencës për operatorët kabllor është përcaktuar si në tabelën në vijim:

Komunat	A	B	C	D	E	Taksa Vjetore (€)
Prishtina	388561	6.2	4	6.3	0.75%	8,884.00
Prizreni	214963	6.2	5	6.3	0.75%	3,932.00
Ferizaj, Mitrovica, Peja, Gjilani, Gjakova, Podujeva	110000	6.2	5	6.3	0.75%	2,012.00
Komunat tjera dhe zonat kadastrale	35000	6.2	6	6.3	0.75%	533.50

4.3 OFRUESIT E SHËRBIMEVE PROGRAMORE

4.3.1 Taksa vjetore për OSHP që ofrojnë shërbimeve televizive audio-vizuale do të jetë ekuivalente me taksën vjetore të aplikuar për subjektet transmetuese tokësore – TV, që i përkasin kategorisë me mbulim regjional (1,890.00 euro); dhe

4.3.2 Taksa vjetore për OSHP që ofrojnë vetëm audio shërbime (radio stacione) do të jetë ekuivalente me taksën vjetore të aplikuar për subjektet transmetuese tokësore – radio, që i përkasin kategorisë me mbulim regjional (1,260.00euro).

Neni 5

Mënyra e pagesës së taksës vjetore

5.1 Taksa Vjetore për licencë për shërbime mediale audio-vizuale do të depozitohet në tërësi në bazë vjetore, në llogarinë bankare të Komisionit të Pavarur për Media, në muajin e parë të vitit respektiv.

5.2 Në rastin e licencimit të ofruesit të shërbimeve mediale audio-vizuale, taksa e parë vjetore për licencë do të paguhet jo më vonë se 14 ditë nga pranimi i vendimit për licencim.

5.3 Në rast se ofruesit të shërbimeve mediale audio-vizuale nuk e informojnë Komisionin e Pavarur për Media se nuk planifikojnë të transmetojnë program më tutje,

përgjegjësitë e ndërmarrja financiare nga licenca do të jenë të vlefshme nga momenti i pranimit të njoftimit me shkrim.

- 5.4 Nëse mbajtësi i licencës ndalon transmetimin para skadimit të kohës për të cilën kohë taksa është paguar, një pjesë e shumës së taksës që i referohet kohës së mbetur nuk do t'i kthehen.
- 5.5 Nëse është vendosur se i licencuari (Radio, TV dhe Operator Kabllor) ka transmetuar jashtë zonës së mbulimit të caktuar në licencën e tij, KPM retro-aktivisht mund t'i caktojë të licencuarit (dyfish) vlerën e taksës që ai do të paguante për zonën e tij të palicencuar nëse ai mbulim i zonës do të përcaktohej në licencën e tij. Kjo pagesë është si shtesë e çdo sanksioni që KPM mund të vendosë.
- 5.6 Në rast të pagesës së taksës me vonesë, e referuar në paragrafin 5.1 dhe 5.3 të këtij neni, personi me licencën e lëshuar për transmetim të shërbimeve mediale audio-vizuale do të paguajë kamatë për vonesë të pagimit të taksës, në pajtim me ligjin për Administratën Tatimore të Kosovës (ATK).
- 5.7 Mospagimi i taksës së licencës, do të rezultojë në sanksionimin e subjektit transmetues, në pajtim me Ligjin dhe Rregulloret e KPM-së. Sanksionimi mund të rezultojë edhe me revokim të licencës.

Neni 6

Vlefshmëria e rregullores

- 6.1 Kjo metodë e përcaktimit të taksës për licencë, do të vlejë vetëm për periudhën kohore deri sa ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale operojnë në bazë të licencës së KPM-së.
- 6.2 Sipas Ligjit të KPM-së, Neni 16.2 Zyra e Shefit Ekzekutiv e rishikon dhe mund të bëjë ndryshime çdo dy (2) vjet në mënyrën e përcaktimit të tarifave të licencave.

Neni 7


Dispozitat kalimtare

- 7.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen vendimet CIMC-2008/01 dhe CIMC-2007/05.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 15 janar 2010.


Filloreta Bytyçi
Kryesuese e Këshillit të KPM-së



data: 15/12/2010